



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 18, datë 16.10.2017

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT GORICË, BASHKIA MALIQ”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i Hidrocentralit Goricë, Bashkia Maliq”, me zhvillues shoqërinë “The Blue Star” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Maliq.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

